



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/111  
Datë: 01.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Gjykatat.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/111  
Datë: 01.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ujitjen e Tokave Bujqësore.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/111  
Datë: 01.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 100.000 (njëqind mijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e kalendarit të ngjarjeve dhe aktiviteteve për shënimin e 100 vjetorit të lindjes së Nënës Tereza - Gonxhe Bojaxhiu.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet për mbulimin e të gjitha shpenzimeve shtesë për shënimin e "Vitet të Nënë Terezës".
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë dhe barten në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në programin "përkrahja e Kulturës", kategoria e subvencioneve, kodi 805.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/111

Datë: 01.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16.8 të Ligjit për Aviacionin Civil, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2010, mori

**V E N D I M**

**Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 03/97 të datës 04.12.2009**

1. Pika 1, 2 dhe 3 e vendimit 03/97 të datës 04.12.2009 kalojnë në 2, 3 dhe 4 ndërsa pika 1. plotësohet me sa vijon:

“Caktohet kompensimi i kryesuesit të Bordit të Autoritetit të Aviacionit Civil në shumë prej 650 (gjashtëqindpesëdhjetë) Euro në muaj.”

2. Kompensimi i anëtarëve të Bordit të Autoritetit të Aviacionit Civil do të jetë në shumë prej 500 (pesëqind) Euro në muaj.
3. Kompensimi do të paguhet nga të ardhurat e dedikuara për Autoritetin e Aviacionit Civil dhe brenda kufijve të planifikuar buxhetor për 2009 dhe 2010.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/111  
Datë: 01.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-086 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Mbeturinave, si dhe të nenit 4, paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2010, mori

**V E N D I M**

1. Qeveria e Kosovës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor të Zyrës Rregullative të Ujësjetës dhe Mbeturinave, i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë :
  - a) Raif Preteni
  - b) Kero Bardhi
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat e kandidatëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, së bashku me CV-të e tyre, t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë